



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0568**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga; Isa Hasani-anëtarë, Vedat Poterqoi-anëtarë dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani-anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Rojet E Nderit” SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 31/11/2023, mori këtë:

### **Vendim**

1. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e OE “Rojet E Nderit” SH.P.K. me nr. 2023/0568 , e datës 11/08/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me numër të prokurimit 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ndërsa Vendimi i AK lidhur me aktivitetin e lartë cekur mbetet në fuqi.
2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 17.05.2023, Komuna Prishtinë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-19-3238-2-1-1. Ndërsa me datën 25.07.2023, AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 2,100,000.00 €

Me 27.07.2023, OE “Rojet E Nderit” SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 03.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Rojet E Nderit” SH.P.K me nr. 568/23 lidhur me aktivitetin “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-19-3238-2-1-1.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Rojet E Nderit" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Operatori Ekonomik ankues ka paraqitur Kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit ndërsa AK në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim ka theksuar se më datë 25.07.2023 ka publikuar Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues përmes të cilit ka njoftuar se është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si në vijim: *“Të gjithë operatorët ekonomik kanë tejkaluar vlerën e parashikuar në mënyrë substanciale apo janë eliminuar për arsye të ndryshme nga vendimet e autoritetit kontraktues ose nga vendimet e OSHP gjatë proceseve paraprake të rivlerësimeve... Autoriteti Kontraktues në dosje - paramasë ka përshkruar vetëm numrin e pozitive dhe orëve pa specifikuar numrin minimal të punëtorëve për këtë aktivitet të shërbimit. Megjithatë shkeljet në këtë aktivitet të prokurimit nuk mund të korrigjohen në këtë fazë, konsiderojmë që është me mirë të bahet anulimi i aktivitetit të prokurimit ashtu që me rastin e ri tenderit Autoriteti Kontraktues të hartoj kritere më të matshme, të specifikuara mirë dhe respektuar LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi.*

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 27, 59, 60 të LPP të Rregullores për Prokurim Publik Ligji nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-237, Ligji nr.05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-92 duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovi ankesën dhe ta detyroni Autoritetin Kontraktues, ta rivlerësoj drejt dhe knoform LPP-së DT-së dhe sqarimeve tuaja duke rishpallur ofertën tonë si më të lirën të përgjegjshme.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 28/08/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 568/23, ndërsa me datë 08/09/2023 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2023/0568 me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në*

*sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon Panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.”*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Fillimisht Ekspertja shqyrtuese sqaron se kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, Vendimi nr. 735,744,757/19; Vendimi nr. 82,83,92/20; Vendimi nr. 332/20; Urdhëresë nr.563/20; Vendimi nr. 896,912/20; Vendimi nr. 230,267/22; Vendimi 359/22; Vendimi 42/23;

Lidhur me pretendimet e OE “Rojet E Nderit” SH.P.K, ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0568 ka vlerësuar pohimet ankimore. Ekspertja shqyrtuese sqaron se më datë, 28.07.2023, OE “Rojet e Nderit SH.P.K”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr : 2023/0568, kundër njoftimit për anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit: "616-19-3238-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës. Më poshtë eksperti shqyrtues jep mendimin e tij në lidhje me aktivitetin e prokurimit. Eksperti shqyrtues sqaron se ky aktivitet i prokurimit është filluar qysh më datë 19.06.2019 dhe për të njëjtin ka një numër të madh të ankesave të cilat janë parashtruar në OSHP dhe si përgjigje ndaj tyre janë nxjerrë gjithsej 7 vendime nga panelet shqyrtuese-OSHP dhe vendime nga AK. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në rrjedhën kronologjike dhe kohore të këtij aktiviteti të prokurimit dhe duke i analizuar çmimet ofertuese të gjithë Operatorëve Ekonomik të cilët kanë ofertuar, sqaron se vlera e ofruar nga secili operator ekonomik që ka marr pjesë në këtë aktivitet prokurimi kalon vlerën e parashikuar për të njëjtin. AK me datën 06.01.2023 kishte marr vendim për anulim të aktivitetit të prokurimit nën arsyetimin se: AK- Komisioni për rivlerësimin e ofertave gjatë ekzaminimit të ofertave konstatoi se të gjithë OE që kanë ofertuar kanë tejkalluar vlerën e parashikuar për këtë projekt. Vlera e parashikuar e këtij projekti ka qenë 2,100,000.00 euro. Sipas Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, paragrafi 2, pika 2.1 thotë si në vazhdim- “2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënie të kontratës vetëm për njërin nga arsyet: 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit”. Duke u bazuar në nenin 62 të LPP –së si dhe çmimet të ofertimit të OE për këtë aktivitet të prokurimit, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pasi të gjithë OE e kanë tejkalluar vlerën e parashikuar të aktivitetit të prokurimit atëherë AK- Komuna e Prishtinës ka të drejtë në marrjen e vendimit për anulim të Aktivitetit të Prokurimit ashtu siç e parasheh edhe Ligji për Prokurim Publik.

Nga lista e OE vrëhet në tabelen përmbledhëse e ofertuesve, përfshirë OE ankues “Rojet E Nderit” kanë ofertuar me çmim shumë me te lart sesa vlera e parashikuar e aktivitetit të prokurimit. Përderisa vlera e parashikuar është 2,100,000.00 € vlera e ofertuar e OE ankues-Rojet e Nderit është 3,107,462.40 €, përkatësisht vlera e ofertuar është për 47.97% më e lartë se ajo e parashikuar apo 1,007,462.40 € më shumë. LPP sqaron qartë mënyrën se si funksionon një kontratë kornizë, mirëpo edhe nëse do ishte marr parasysh përgjigja që AK kishte dhënë me datë 03.06.2019 e cila edhe në këtë rast nuk është në përputhje me LPP-në, lidhur me pyetjen e parashtruar nga OE ankues nëse vlera e parashikuar është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e aktivitetit, ku AK kishte thënë se *“Kontrata Kornizë mund të shtohet edhe për 30% e që arrijnë vlerën 2,730,000.00€ përsëri vlera e ofertuesit është shumë më e lartë në krahasim me vlerën e parashikuar”*. Andaj duke bazuar në këtë çfarë u sqarua më lartë, vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform nenit 62 të Ligjit të Prokurimit Publik, i cili shpjegon se kur një aktivitet i prokurimit mund të anulohet.”

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Rojet e Nderit Argumentimi në raportin e ekspertës shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Paneli shqyrtues në kontekstin e fakteve dhe dokumenteve të analizuara si më sipër nga raporti ekspertës shqyrtuese konstaton, se Operatori Ekonomik ankues e ka kaluar vlerën e parashikuar të aktivitetit të prokurimit, i cili ka qene i përcaktuar me buxhetin e Autoritetit Kontraktues për Aktivitetin e Prokurimit “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-19-32, në vlerën, është 2,100,000.00 €, ndërsa OE ankues ka ofertuar me shumën monetare prej; 3,107,462.40 €,

Neni 62, paragrafi 2 dhe nen-paragrafi 2.1. i Ligjit të Prokurimit Publik përcaktojnë përfundimin e aktivitetit të prokurimit” *2..Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënie të kontratës vetëm për njërin nga arsyet: 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit”*

Paneli Shqyrtues bazuar në faktet e lartshënuara ka vendosur refuzimin e ankesës së OE ankues”- Rojet e Nderit “ dhe konstaton se Autoritetit Kontraktues, ka vendosur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik, për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. 616-19-3238-2-1-1.për

“Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Rojet E Nderit SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: